

Sekretariati i BSPSH-së është organ operativ ekzekutiv që realizon dejtimin e përditshëm të veprimatrive sindikale nën drejtimin e Presidentit të BSPSH-së. Ai përbëhet nga:

- Zv/Presidenti i BSPSH;
- Sekretarët e BSPSH dhe ndihmës Sekretarët;
- Përfaqësuesja e Forumit të Gruas;
- Përfaqësuesja e Forumit të Rinisë.
- Kryetari i Kontroll Revizionit

Zv/Presidenti dhe Sekretarët e BSPSH-së, janë me mandat të miratuar nga Asambleja Kombëtare, me propozim të Presidentit të BSPSH-së. Miratimi i tyre bëhet me votim të fshehtë (kur janë dy kandidatë) ose me votim të hapur (kur është një kandidat) pasi të kenë fituar me shumicën e thjeshtë të votave 50 % + 1, në të kundërtën, Presidenti ka të drejtën që të bëjë propozime për kandidatura të tjera. Në të gjitha rastet e shkarkimeve të sekretarëve, Zv/presidentit të BSPSH-së, nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të forumit që i ka miratuar. Për këto raste propozimi bëhet nga Presidenti BSPSH-së.

Ndihmës sekretarët, janë persona të emëruar nga Presidenti dhe janë në përbërje të personelit administrativ të BSPSH-së.